



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË  
K R Y E S I A

Nr. 529 prot.

Tiranë, më 22 dhjetor 2017

V e n d i m

Nr. 23, datë 22 dhjetor 2017

**Për aprovimin e kalendarit të reformës institucionale në Akademinë e Shkencave  
(janar-mars 2018)**

**Drejtuar:** Anëtarëve të Asamblesë së Akademisë së Shkencave  
Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike  
Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike  
Komisionit *ad hoc*  
Sektorit të bibliotekës dhe të botimeve shkencore  
Sektorit të financës  
Sektorit të personelit

**Për dijeni:** Kryeministrisë  
Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë  
ALLEA  
Akademië LEOPOLDINA

Mbështetur:

1. ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", neni 4, pika c;
  2. statutit të Akademisë së Shkencave, neni 2, pika 10 dhe 12;
  3. kodit europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor;
- Asambleja e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 22 dhjetor 2017, me rend dite të shpallur (shih <http://www.akad.gov.al/ash/12-te-reja/322-mbledhje-e-asamblese-se-akademise-se-shkencave>) edhe bashkëmbyllur; pas verifikimit të kuorumit të domosdoshëm për fillimin e mbledhjes, vlefshmërinë e saj dhe të vendimeve (shih *listë-prezencën*) dhe pas aprovimit të rendit të ditës sa më sipër; në pajtim me detyrën funksionale të institucionit dhe me ndjenjë përgjegjësie për përmbylljen e procesit të ristrukturimit të Akademisë së Shkencave;

### **Pasi konstatoi se:**

- drafti i reformës i hartuar nga Komisioni Ad Hoc dhe i aprovuar nga Asambleja e ASH-së i paraqitur zyrtarisht pranë Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë është një dokument bazë për të vijuar më tej procesin e reformës përmes hartimit dhe aprovimit të dokumenteve ligjore e nënligjore bazë të saj;

- kalendari i hapave të reformës i paraqitur në emër të Këshillit Ekzekutiv të ASH-së nga ana e sekretarit shkencor akademik Vasil S. Tole (*shih materialin bashkëmbyllur*), pasuar me diskutimet për këtë çështje të akademikëve: *Apollon Bace, Jorgaq Kacani, Beqir Meta, Dhimitër Haxhimihali, Kosta Barjaba, Aurela Anastasi, Skënder Gjinushi, Arjan Durrësi, Shaban Sinani, Salvatore Bushati, Gudar Beqiraj, Muzafer Korkuti dhe Florian Vila*, duhet të aprovohet nga asambleja e ASH-së për të çuar deri në fund procesin e nisur reformues;

me votim të hapur e unanim

### **Vendosi:**

1. Të aprovohet kalendarin e hapave dhe dokumenteve të reformës në Akademinë e Shkencave.

2. Kalendari parashikon:

2.1 Vullnetin për ngritjen e *“Komisionit të përbashkët të mirëbesimit, për ndjekjen dhe monitorimin e procesit të reformimit”*, midis Akademisë së Shkencave dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë.

2.2 Hartimin i draft-ligjit *“Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”*.

2.3 Hartimin e draftit të VKM-së *“Për organikën e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë”*.

2.4 Hartimin e draftit të *“Statutit”* të ASH-së, si dhe hartimin e dokumenteve:

*“Kriteret dhe standardet e pranimeve të reja si ‘akademik’ dhe ‘akademik i asociuar’ dhe*

*“Kriteret dhe standardet e konkurrimit në pozicionet drejtuese të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë”*.

2.5 Hartimin e draftit të *“Kodit akademik të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”*.

3. Asambleja autorizoi Këshillin Ekzekutiv që të informojë Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për vendimmarrjen e kësaj mbledhjeje dhe njëkohësisht të kërkojë bashkëpunimin e tyre institucional në këtë proces të përbashkët për ngritjen e grupeve të punës të reformës përmes akteve urdhëruese përkatëse, për hartimin në kohën e duhur (mars 2017), të draft-ligjit të *“Akademisë së Shkencave të Shqipërisë”*, të draftit të VKM-së *“Për organikën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë”* dhe të *“Kodit akademik të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”*.

4. Asambleja vendosi që Komisioni *Ad Hoc* i reformës të hartojë brenda muajit shkurt 2018 draftet e akteve të vetëreformimit, si “Statuti” i ASH-së dhe dokumentet: “Kriteret dhe standardet e pranimeve të reja si ‘akademik’ dhe ‘akademik i asociuar’” dhe “Kriteret dhe standardet e konkurrimit në pozicionet drejtuese të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë”. Draftet e mësipërme dhe dokumentet e tjera të paraqiten në mbledhjen e Asamblesë së ASH-së të muajit mars 2018, për shqyrtim dhe aprovim, duke kërkuar për to paraprakisht edhe ekspertizën e ALLEA-s dhe Akademisë LEOPOLDINA.

5. Asambleja vendosi që të gjitha draftet e dokumenteve të paketës së reformës të përcillen zyrtarisht pranë instancave përkatëse brenda muajit mars 2018.

6. Këshilli Ekzekutiv, kryesia dhe administrata e Akademisë së Shkencave të mbështesë në të gjitha format përmbushjen e pikave të kalendarit të hapave të reformës në Akademinë e Shkencave, duke përfshirë mbështetjen infrastrukture dhe atë financiare. Kryesia të vlerësojë dhe të konkretizojë rast pas rasti të gjithë ata mekanizma të nevojshëm lehtësues për punën e grupeve të punës dhe të Komisionit Ad Hoc.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen seksionet gjegjëse shkencore të Akademisë së Shkencave dhe nënstrukturat e tjera të saj, përmendur në krye të këtij vendimi.

8. Ngarkohet specialisti i komunikimeve shkencore, marrëdhëniet me jashtë dhe publikun për njoftimin e këtij vendimi.

9. Ngarkohet specialisti i shërbimit IT për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Akademisë së Shkencave.

10. Ngarkohet Këshilli Ekzekutiv për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretar Shkencor**

Vasil S. Tole

